



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 367/7 Prot.

Tiranë, më 27.09.2019

V E N D I M

Nr. 91, Datë 27.09.2019

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PATOS “MBI AUDITIMIN FINANCIAR
DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2019)

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Patos me objekt: “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë, për prokurimet publike”, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.06.2019, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionimi të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm si dhe Drejtori i Auditit të Brendshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Patos sipas programit të auditimit nr. 367/1, prot, datë 28.05.2019, ndryshuar me nr. 367/2, datë 04.07.2019, për periudhën 01.01.2017 - 30.06.2019.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Bashkia Patos” për vitet ushtrimorë nga 1 Janar 2017 deri më 30 Qershor 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2017 dhe 2018.

Auditimi përfshin pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve, pagesave*) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimi, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Patos, të standardeve mbi raportimin financiar, të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për Bashkinë Patos, për vitin 2018.

Përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura të cilat janë të korigjueshme në periudhat e ardhshme, bazuar në këto, ne arrijmë në përfundimin *për dhënien e një opinionit të kualifikuar*.¹

Janë konstatuar parregullsi në pasqyrat financiare si vijon:

-Llogaria “*Toka, troje, terrene*” në **pasqyra financiare të vitit 2017**, është për vlerën kontabël (historike) 36,025,029 lekë **dhe në vitin 2018** për vlerën neto 4,741,703 lekë.

Nga analiza kontabël e kësaj llogarie, është konstatuar se:

Në këtë llogari janë kontabilizuar edhe vlera të trojeve të varrezave të qytetit si dhe të trojeve nën objekte ndërtimi për të cilat mungojnë të dhënat e nevojshme për mënyrën se si janë vlerësuar me çmim sipërfaqet e trojeve, baza ligjore e këtij vlerësimi.

Në këtë llogari, është kontabilizuar edhe vlera e 5 objekteve ndërtimore që janë qendra shëndetësore në vlerën 875,553 lekë, të cilat nisur nga përmbajtja ekonomike, duhet të kontabilizohen në debi të llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”.

Për vitin 2018, tarifa e përdorur për vlerën e amortizimit për këtë llogari, është 1%, referuar UMF nr. 8 datë 9.03.2018, duhej të përdorej tarifa 5%.

-**Për vitet 2017 dhe 2018**, nuk është mbajtur llogaria 231 “*Shpenzimet në proces për rritjen e Aseteve të Qëndrueshme të trupëzuara*”, megjithëse gjatë vitit ushtrimor është konstatuar se ka pasur investime të cilat në fund të periudhës kanë rezultuar të pa mbyllura.

Konkretisht, në fund të periudhës ushtrimore të **vitit 2017**, nuk janë paraqitur si investime në proces 3 raste në shumën totale 138,339,373 lekë, por janë paraqitur si aktive të përfunduara.

-Nga inventarizimi i kryer për Aktivet e Qëndrueshme **të vitit 2018**, ka rezultuar në 4 raste objekte ndërtimore, (llogaria 2012), posedohen nga persona private, kurse Bashkia Patos i ka përfituar këto asete me VKM nr. datë 15.06.2016 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Patos, të Qarkut Fier, për njësinë administrative Patos*”.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Patos

¹ Një opinion i kualifikuar jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Patos, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Patos, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

1. Në Bashkinë Patos, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

2. Detyrimet e faturuara të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2018 janë në vlerën **62,599,642 lekë**.

3. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

4. Në hartimin e kërkesave për kualifikim, u konstatua se në 1 procedurë, nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, duke rritur fondin limit me 215,760 lekë m shumë por që nuk ka ndikuar në shpalljen e fituesit, veprime që nuk përputhen me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime.

5. Në zbatimin e punimeve të 6 (shtatë) kontratave, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **2,941,903 lekë**.

6. Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime që nuk përputhen me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në 5 procedura të shoqëruar me shpenzime jo sipas 3-E në shumën **46,521,420 lekë**.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Patos.

Drejtimi i Bashkisë Patos, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një

opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” për vitin 2017 është në vlerën kontabël 36,025,029 lekë dhe për vitin 2018, është në vlerën neto 4,741,703 lekë.

Sipas të dhënave të inventarizimit fizik, rezulton se **për vitin** 2017, kjo llogari është e analizuar për 19 objekte.

-Në këtë llogari, janë kontabilizuar edhe vlerat e trojeve për varrezat si dhe trojet për objektet e ndërtimit për të cilat mungojnë të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për mënyrën se si janë vlerësuar me çmim sipërfaqet e trojeve të kontabilizuara në këtë llogari. Konkretisht, vlera e truallit të ndërtesës së Bashkisë Patos është kontabilizuar për vlerën 993,600 lekë.

-Në këtë llogari, janë kontabilizuar edhe 5 objekte ndërtimore që janë Qendra Shëndetësore për vlerën kontabël gjithsej 875,553 lekë, të cilat si të tilla duhej të ishin kontabilizuar në debi të llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”.

Kontabilizimi i vlerës së trojeve në mungesë të dokumenteve të nevojshme dhe bazës ligjore për vlerësimin e tyre, **është shkelje** e kërkesave të VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjsteve që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

-**Për vitin 2018**, amortizimi vjetor për aktivet e kësaj llogarie, është llogaritur me tarifën 1% të vlerës kontabël historike, ndërkohë që duhej të llogaritej me tarifën 5% të vlerës kontabël, në këtë rast, tarifa e aplikuar për amortizim, **është në kundërshtim** me kërkesat e pika 36, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”. (Trajtuar hollësisht në faqet 58-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa duke ngritur grup pune me specialistë të fushës, **me qëllim:**

-Për të shqyrtuar dhe rivlerësuar me përgjegjësi dokumentacionin teknik e kontabël të vlerësimit me çmim të trojeve dhe terreneve.

-Të bëhet sistemimi i llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, duke kontabilizuar në debi të saj, vetëm objektet që nga përmbajtja ekonomike i përkasin kësaj llogari sipas specifikimeve të Planit Kontabël, miratuar me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjsteve që varen prej tyre*” i ndryshuar.

-Të sistemohet vlera e amortizimit vjetor të kësaj llogari, duke aplikuar tarifa të amortizimit sipas miratimit me UMF nr. 8 datë 09.03.2018.

Brenda vitit 2019

2.Gjetje nga auditimi: Për vitet 2017 dhe 2018, nuk është mbajtur llogaria 231 “Shpenzimet në proces për rritjen e Aseteve të Qëndrueshme të trupëzuar”, megjithëse gjatë vitit ushtrimor është konstatuar se ka pasur investime të cilat në fund të vitit kanë rezultuar të pa mbyllura, pra në proces. Në këto raste, vlerat e situacioneve për punimet në proces, janë kontabilizuar direkt në llogaritë e Aktiveve të Qëndrueshme përkatëse.

Nga auditimi u konstatua se, në fund të periudhës ushtrimore **të vitit 2017**, nuk janë paraqitur investime në proces për 3 raste në shumën totale 138,339,373 lekë që u përkasin 3 objekteve të financuara si vijon:

-Rikonstruksion i rrugës Grizë për shumën 13,235,700 lekë,

-Rikonstruksion rruga Gropallarëve Grizë Velaj për 1,800,000 lekë dhe

-Rikonstruksion i rrugës Unaza për 123,303,673 lekë.

Kjo praktikë e kontabilizimit të investimeve në proces, **është në kundërshtim** me kërkesat e pikës 3, Kap. II të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe pikat 16/d, 18, Kap. II të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar. (Trajtuar hollësisht në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, të marrë masat dhe të ndryshojë praktikën e kontabilizimit të situacioneve për objektet në proces investimi duke debituar llogarinë 231 “Shpenzimet në proces për rritjen e A. Qëndrueshme të trupëzuar”. Mbyllja e kësaj llogarie, të bëhet vetëm pas arkivimit në Drejtorinë e Financës, të Aktit të marrjes në dorëzim të objektit të financiar, të miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë e vazhdimisht

3.Gjetje nga auditimi: Bashkia Patos ka në vartësi të saj, 5 Njësi Vartëse me status Juridik më vete të cilat janë:

Ndërmarrja e Mirëmbajtjes Urbane, Ndërmarrja e Pastrimit, Ndërmarrja e Gjellbërimit, Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Klubi Shumë sportesh.

Për vitet 2017 dhe 2018, Investimet për llogari të Njësive Vartëse, janë kryer nga Bashkia Patos dhe me përfundimin e tyre, është bërë transferimi i asetëve për Njësitë përkatëse.

Në vitin 2017 janë transferuar asete nga Bashkia Patos në Njësitë vartëse gjithsej në vlerën 284,182,543 lekë, nga të cilat për Ndërmarrjen e Ujësjetës në vlerën 20,048,573 lekë.

Në vitin 2018, janë transferuar asete gjithsej në vlerën 307,084,891 lekë, nga të cilat për Ndërmarrjen e Ujësjetës në vlerën 36,689,694 lekë.

Nga auditimi i procedurave për transferimin e asetëve për Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve, u konstatuan se:

-Asetete e transferuara, përfaqësojnë vlerën e pjesës së situacioneve për tubacionet e ujit në investimet e kryera për rikonstruksionin e rrugëve të qytetit.

-Ndarja e vlerës së investimit për njësinë përkatëse, është bërë nga specialistët e Bashkisë Patos, bazuar në situacionin përfundimtar sipas aktit të marrjes në dorëzim të objektit të prokuruar.

Nga Bashkia Patos dhe Njësitë vartëse, nuk janë mbajtur akte rakordimi mbi dorëzimin e objekteve që transferohen, të shoqëruara me kopje të projekteve përkatëse të dorëzuara si; planimetritë, gen-planet projektet etj. veprime dhe mosveprime **në kundërshtim** me pikat 26, 30, 35/b, 36 dhe 57 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e

Sektorit Publik” i ndryshuar. (Trajtuar hollësisht në faqen 60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, të marrë masat, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe financiar dhe të kryej dorëzimin tek Njësitë e Varësisë, të cilave u janë transferuar në mënyrë kontabël asetet e investuara nga Bashkia Patos sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë e vazhdimisht

4.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të viteve 2017 dhe 2018, nuk janë evidentuar detyrimet e angazhimit financiar për periudhat e ardhshme bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit dhe të kontratave për qira dhënie të aseteve.

Për nxjerrjen e pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk është bërë rakordimi me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatikë Financiar të Qeverisë (SIFQ) mbi pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive, për pasqyrën e të ardhurave dhe për pasqyrën e performancës financiare, **në kundërshtim** me kërkesat e përcaktuara në pikat 38, 39 dhe 40, Kap. II të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Trajtuar hollësisht në faqet 63-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, të marrë masat për regjistrimin kontabël të detyrimeve të lindura për shkak të angazhimeve sipas sipas kontratave të lidhura me subjekte sipërmarrëse përfshi kontratat për dhënie me qira të aseteve.

Për të pasqyruar saktë treguesit financiarë të burimeve dhe detyrimeve financiare, në fund të periudhave ushtrimore, të rakordohet me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatikë Financiar të Qeverisë.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rezultateve të inventarizimit të aseteve për vitin 2018, u konstatua se:

-Janë indentifikuar **4 raste** në të cilat pronat e Bashkisë që janë transferuar me VKM nr. 443 datë 15.06.2016 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Patos, të Qarkut Fier, për njësinë administrative Patos”, por rezulton se këto prona zotërohen nga qytetarë të ndryshëm, konkretisht objektet:

Kopshti ndërshkollor, ndërtesa e zdruktarisë së varrezave në lagjen e Re, Pallati i Kulturës në lagjen e Re dhe Kopshti nr. 3 lagja e Re.

-Lidhur me këtë fakt, Bashkia Patos, **nuk ka marrë masat e nevojshme** dhe nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore me qëllim që këto objekte të administrohen për nevoja publike, **në zbatim të kërkesave** të neni 9, pika 12, Kreu III dhe neni 23, Kreu VII të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

-Llogaritë inventariale të Aktiveve të Qëndrueshme, janë mbajtur në kontabilitet të analizuara sipas llojit të aktiveve dhe sipas objekteve, por nga Drejtoria e Aseteve, **nuk janë hapur regjistra të Aktiveve të Qëndrueshme në kundërshtim me kërkesat sipas** pikës 26, 27 dhe 30, Kap. III të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Sipas të dhënave analitike të evidencave kontabël, konstatohet se janë në inventar gjithsej 80 objekte ndërtime, nga të cilat; kontabilizuar në llogarinë 210 “Toka troje dhe terrene” 19 objekte dhe në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” 61 objekte.

Nga auditimi mbi regjistrimin e Aktiveve të Qëndrueshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në pronësi të Bashkisë Patos, konstatohet se kanë marrë certifikatën e

pronësisë ose janë në proces regjistrimi, 38 objekte, nga të cilat; për 7 objekte është marrë certifikatat e pronësisë dhe 31 objekte, janë në proces regjistrimi.

Për diferencën prej 42 objektesh, ***nuk është proceduar për regjistrimin e tyre në pronësi*** të Bashkisë Patos, ***në kundërshtim*** me kërkesat e Kap. III, neni 9, pika 12 dhe Kap. VII, neni 23, pika 14 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar. (Trajtuar hollësisht në faqet 64-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masat që me specialist të fushës, ***të saktësojë pronat të cilat padrejtësisht zotërohen nga persona të ndryshëm*** dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për lirimin dhe administrimin e tyre në interes publik.

Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Drejtorinë e Planifikimit Territorit, të marrin masat ***për krijimin e regjistrimit të asetëve*** dhe vazhdimin e procedurave ***për regjistrimin e tyre në pronësi*** të Bashkisë Patos në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Menjëherë e vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën neto të saj 497,420 lekë, në pasqyrat financiare të vitit 2018, është e analizuar për 3 studime dhe projekte.

Për këtë llogari, nuk është kryer ndonjëherë inventar fizik të studimeve dhe projekteve në ngarkim të personave që i administrojnë këto, praktikë ***në kundërshtim*** me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe Kap. III, pika 36 të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Trajtuar hollësisht në faqet 65-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Të merren masat, të verifikohet saktësia e llogarisë 202 “*Studime e projekte*” bazuar në inventarizimin mbi gjendjen fizike të studimeve dhe projekteve të financuara në vite në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e debitorëve në fund të vitit 2018, llogari 468, rezulton në vlerën kontabël **18,986,663 lekë**.

Kjo llogari është e analizuar për 50 subjekte debitorë shumë prej tyre në vitet paraardhëse si dhe nga rekomandimet e KLSH-së në vitin 2017.

Për vjeljen e detyrimeve debitorë, nga Bashkia Patos, ***nuk është proceduar me kërkesë padi në gjykatë***.

Megjithatë ***aftësia paguese e*** Bashkisë Patos, në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, ***është përmirësuar***. Në vitin 2017, detyrimet kreditore janë më të mëdha se ato debitorë për diferencën 62,599,643- 20,334,057= 42,265,586 lekë, kurse në vitin 2018 kërkesat për arkëtim, janë më të mëdha se sa detyrimet kreditore për diferencën 18,986,663-18,303,997= 682,666 lekë (Trajtuar hollësisht në faqet 66-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre ***duke bërë kërkesë padi në gjykatë***.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Brenda vitit 2019

8. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është për vlerën kontabël 33,078,612 lekë.

Kjo llogari është e analizuar për 53 objekte investimi për të cilat janë ngurtësuar fondet sipas kushteve të kontratës, sipas objekteve të kontraktuara dhe sipas afatit të përfundimit të garancisë. Nga këto ngurtësime:

-Në 9 raste me vlerë të ngurtësuar për 20,077,812 lekë, afati i garancisë është parashikuar brenda vitit 2019, *kurse për diferencën 44 raste të tjera me vlerë të ngurtësuar për 13,000,800 lekë, ka kaluar afati i garancisë disa për shumë vite.*

-*Për 8 raste me vlerë të ngurtësuar për 2,747,253 lekë, subjekti sipërmarrës i punimeve, ka humbur të drejtën ligjore për të kërkuar vlerën e garancisë* së punimeve pasi në fund të periudhës së garancisë së punimeve, janë konstatua punime me cilësi të dobët të cilat janë riparuar nga Investitori; Bashkia Patos.

Në total, në 17 raste për vlerën e ngurtësuar 15,748,053 lekë, të vlerësuar të ardhura të munguara për Bashkinë Patos, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për ngurtësimin e këtyre fondeve rastet kur subjektet kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, ti përdorë ato për interesin publik. (Trajtuar hollësisht në faqen 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë e vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi programimin dhe zbatimin e buxhetit për Bashkinë Patos *për vitet 2017, 2018 dhe 2019*, nuk u konstatuan shkelje për tu theksuar në procedurat ligjore, përveç në një rast në vitin 2017, *nuk ka kaluar për miratim* në Këshillin e Bashkisë si emërtim objekti: “Rikonstruksion i ish kopshtit në Lagjen e Re në banesa sociale” me fondin limit për 17,032,283 lekë pa tvsh, financuar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), praktikë *në kundërshtim* me kërkesat e pika 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm”.

-Nga analiza e treguesve të fondeve të programeve buxhetore të miratuara për vitet 2017, 2018 dhe 2019, *konstatohet:*

1-Në total, treguesit faktikë të buxhetit për Bashkinë Patos në vitin 2017, *janë realizuar* në masën 80% dhe për vitin 2018, janë realizuar në masën 83%.

Buxhetet vjetore të programuara, kanë ardhur në ulje për shkak të zvogëlimit të grandeve buxhetore megjithëse të ardhurat e veta, kanë ardhur duke u rritur, konkretisht:

Për vitin 2017 buxheti është programuar në total për shumën 1,071,008 mijë lekë, për vitin 2018, buxheti është programuar 17,4 % më i vogël se në vitin 2017 dhe për vitin 2019, është programuar 14% më i vogël se në vitin 2018.

2-Të ardhurat e veta dhe ato të trashëguara nga viti paraardhës, për vitin 2017 janë programuar për 293,146 mijë lekë ose 27% e totalit vjetor, në vitin 2018, janë programuar për 348,289 mijë lekë, 18,8 % më shumë se në vitin 2017 ose 39% e totalit të këtij viti dhe për vitin 2019, janë programuar për 348,288 mijë lekë, të cilat janë në nivelin e vitit 2018 ose 45,5% e totalit të këtij viti.

3-Buxheti i përdorur nga Bashkia Patos, pa pjesën që është deleguar për tu përdorur nga Njësitë vartëse të saj, ka ardhur duke u zvogëluar në krahasim me buxhetin total vjetor, konkretisht:

Në vitin 2017, programuar për tu përdorur nga Bashkia Patos 975,856 mijë lekë ose 91% e totalit të buxhetit, në vitin 2018, programuar për tu përdorur 785,213 mijë lekë ose 88% e totalit të vitit dhe në vitin 2019, programuar për tu përdorur 617,771 mijë lekë ose 81% e totalit të vitit.

4-Shpenzimet për pagat e punonjësve, llogaria 600 dhe shpenzimet operative, llogaria 602 të programuara për Bashkinë Patos, janë në nivele të qëndrueshme, me rritje të vogla për vitet 2017- 2019. (Trajtuar hollësisht në faqet 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit.

Në ecuri, të marrë masa për rritjen e performancës të Njësive Vartëse të saj, duke synuar rritjen e efektivitetit të investimeve dhe shpenzimeve menaxhuese.

Menjëherë e në vijueshmëri

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nga disa punonjës të administratës Bashkisë Patos, nuk njihen dhe zbatohen plotësisht sa duhet, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm *(Trajtuar hollësisht në faqen 14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Bashkia Patos, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës Njësise së Auditit të Brendshëm Publik , të marrin masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe 5 komponentëve të tij.

-Bashkia Patos nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit të marrë masa për përditësimin e Rregullores dhe Kodit Etik duke pasqyruar ndryshimet e bëra në strukturën organizative duke bërë ndryshimet përkatëse në respektim të ligjit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësise.

-Gjithashtu, nga ana e Titullarit të njësise të merren masa për plotësimin e sektorëve kryesor të administratës për të mundësuar realizimin e objektivave.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Patos, për periudhën 2017, 2018 dhe 6 mujori i parë i vitit 2019, nuk ishin pajisur me leje nga ana e bashkisë subjektet “L...” shpk me NIPT K.....Q dhe subjekti “P. S.” me nipt K.....M *(Trajtuar hollësisht në faqet 51-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Drejtori i Shërbimit të marri masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të kësaj tarife, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve për konsumatorët fundorë në këtë bashki.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi : Në Bashkinë Patos për vitin 2017-2018 dhe 6 mujorin e parë 2019 për vjeljen dhe grumbullimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë bazuar në VKM. Nr.860 datë 10.12.2014 janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZNI-it. Debitor të mbetur për vitin 2017, 2018 dhe 6 mujorin e parë 2019 janë 394 qytetar dhe subjekte në vlerën **13,309,757 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara. *(Trajtuar hollësisht në faqet 42-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Bashkia Patos të marrë masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **13,309,757 lekë**, për të gjitha subjektet dhe familjarët që janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi në Bashkinë Patos për vitet 2017, 2018 dhe 6 mujorin 2019 figurojnë debitorë për taksat e tarifave vendore, familjarë në vlerën prej **20,506,276 lekë**, për mos pagesën e detyrimeve (për taksë toke për 2942 familje në vlerën 11,460,779 lekë, taksë ndërtese për 2881 familje në vlerën 1,670,497 lekë, tarifë pastrimi për 3885 familje në vlerën 7,375,000 lekë).

-Në Njësinë Administrative Ruzhdie janë lidhur kontrata me fermerët për dhënien me qira për tokat bujqësore të pandara të cilat janë administruar në kohën kur komuna Ruzhdie administrohej më vete si Komuna Ruzhdie. Të gjitha këto kontrata janë të pa lidhura përpara noterit dhe nga ballafaqimi del se këto prona të bashkisë nuk është bërë azhurnimi dhe në pamundësi të saj nuk mund të lidhin kontrata. Vetëm me 3 qytetar është bërë e mundur lidhja e kontratës përpara noterit për vitin 2019. Në bazë të ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, udhëzimit KM nr. 3, datë 16.05.2007 ndryshuar me udhëzimin e KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira për tokat bujqësore të pandara”, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 826 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 ”Kodi Civil i RSH” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet **me akt noterial** dhe të regjistrohet në regjistrin publik. Dhe neni 827, ku përcaktohet se: Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme, si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie.* Janë lidhur 68 kontrata qiraje afatgjata nga viti 2009 deri në vitin 2012. Nga këto kontrata qiraje për vitin 2017 dhe 2018, rezultojnë debitor në Bashkinë Patos në **vlerën totale prej 266,630 lekë**.

-Nga auditimi i të dhënave të Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se për vitet 2017-2018 dhe 6 mujorin e parë 2019, subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh për taksë ndërtese dhe tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi etj, janë debitorë për mos pagesën e detyrimeve tatimore, në vlerën prej 9,030,529 lekë. (Trajtuar hollësisht në faqet 42-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Nga Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 29,803,435 lekë për taksat e tarifave vendore për familjarët, për lidhjen e kontratave të qirasë përpara noterit e taksave vendore nga bizneset. Bashkia Patos të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 93 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë e në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në bashkinë Patos 2 nga audituesit e këtij sektori janë të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” neni 11, Vendimin e KM nr. 83, datë 03.02.2016 për “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditit të brendshëm në sektorin publik” pika 3. (Trajtuar hollësisht në faqen 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për pajisjen e audituesve me certifikata të auditit të brendshëm. Dy punonjësit e pa certifikuar të njësisë auditit të brendshëm të vazhdojnë trajnimet dhe dhënien e provimeve për certifikim e tyre pranë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (**Bashkia Patos**), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,941,903 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikualifimi Urban i Shëtitores Republika”*, **Bashkia Patos**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 96,285,666 lekë, fituar nga BOE “E. K.” shpk & “F.” SHPK & “A.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 161,000 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 683/14 prot datë 03.11.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “E. K.” shpk & “F.” SHPK & “A.” SHPK (*trajtuar më hollësisht në faqet 96-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **161,000lekë pa tvsh** nga BOE “E. K.” shpk & “F.” SHPK & “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 683/14 prot datë 03.11.2016, me objekt “Rikualifikimi Urban i Shëtitores Republika”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Ndërtimi i shërbimit me një ndalesë ONE STOP SHOP + Salla e Këshillit”*, **Bashkia Patos**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 27,020,316 lekë, fituar nga BOE “I. G.” SHPK & “H.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 505,250 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2164/10 prot datë 27.02.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “I. G.” SHPK & “H.” SHPK (*trajtuar më hollësisht në faqet 98-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **505,250lekë pa tvsh** nga BOE “I. G.” SHPK & “H.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2164/10 prot datë 27.02.2018, me objekt “Ndërtimi i shërbimit me një ndalesë ONE STOP SHOP + Salla e Këshillit”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Rikonstruksion i rrugës Unaza”, **Bashkia Patos**, me vlerë të kontratës 147,146,844 lekë me TVSH, fituar nga OE “G... C.” SHPK, rezultoi se zëri i punimeve “Zëri 5 (An) Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²” është paguar dy herë duke

shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **1,321,591 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1718/10 prot, datë 20.04.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe sipërmarrësit OE “G.. C.” SHPK *(trajtuar më hollësisht në faqet 101-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,321,591 lekë pa TVSH** nga OE “G.. C.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1718/10 prot datë 20.04.2018, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unaza”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit dy herë për trajtimin e dubluar “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj”, *Bashkia Patos*, me vlerë të kontratës 25,440,540 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S.” SHPK & “J.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **664,600 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: “Zëri 1 (3.212/b) Shtresë stabilizanti, t=10 cm”; “Zëri 2 (3.210) Shtresë çakulli mbeturinë, t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”; “Zëri 5(2.262/3) Shtresë betoni C 12/15 (nën bordura + muret mbajtëse)”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 829/16 prot, datë 31.08.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “S.” SHPK & “J.” SHPK *(trajtuar më hollësisht në faqet 101-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **664,600 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S.” SHPK & “J.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 829/16 prot datë 31.08.2017, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Buzaj, Rrerës”, *Bashkia Patos*, me vlerë të kontratës 23,504,166 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “H.” SHPK & “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **112,600 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: “Shtresë asfalto betoni me zall lavatriçe, 3 cm, me makineri + degëzime”; “Shtresë stabilizanti t=10 cm”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1958/7 Prot, datë 09.11.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “H.” SHPK, & “Sh.” SHPK *(trajtuar më hollësisht në faqet 104-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **112,600 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “H.” SHPK & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1958/7 Prot, datë 09.11.2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Buzaj, Rrerës”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier – Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve”, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës 5,857,472 lekë me TVSH, fituar nga Operatorit Ekonomik “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **176,862 lekë pa TVSH**, për zërin e punimeve: Zëri 7(An) Urë me konstruksione metalike të përbëra + themel b/arme. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1636/12 Prot, datë 12.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomik “Sh.” SHPK *(trajtuar më hollësisht në faqet 106-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **176,862 lekë pa TVSH** nga Operatorit Ekonomik “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1636/12 Prot, datë 12.09.2018, me objekt “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier – Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës prokurimit me objekt “Blerje mjet makine vetëshkarkuese”, me FL në vlerën 2,916,666 lekë, OE i shpallur fitues ” S.” me vlerë të ofertës 2,866,660 lekë, procedurë e cila është anuluar nga AK si pasojë e mosplotësimit të kriterëve të mjetit të paraqitur. Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24, Sigurimi i kontratës, nga ana e Bashkisë Patos nuk është mbajtur sigurimi i kontratës në shumën **343,999 lekë me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Patos.***(trajtuar më hollësisht në faqet 86-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Bashkia Patos, drejtorja e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës **343,999 lekë** si sigurim kontrate OE “S.” SHPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjet makine vetëshkarkuese”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24.

Menjëherë

C/I. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, (në 5 procedura për vlerën 46,521,420 lekë) si më poshtë:

C/I.1.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “**Rikonstruksion i Rrugës Unaze –Grize Velaj**”, me Fondin Limit të prokurimit në vlerën 22,464,816 lekë, BOE i shpallur fitues ”S.” SHPK & “J.” SHPK me vlerë të ofertës **21,200,450 lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anulim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike

pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **21,200,450 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

C/I.2.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje bazë materiale për rikonstrukcionin e rrugëve të brendshme në Njësinë Administrative Zharrëz**”, me FL në vlerën 14,460,363.6 lekë, OE i shpallur fitues ” A. C.” me vlerë të ofertës **14,426,880 lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anulim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **14,426,880 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese e cila rezulton dhe e vetmja e paraqitur), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

C/I.3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje rëre bituminoze për shtrim rrugësh**”, me FL në vlerën 8,321,300 lekë, OE i shpallur fitues ” A. C.” me vlerë të ofertës 8,293,000 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anulim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **8,293,000lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

C/I.4.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje baze materiale te ndryshme për sistemin e Ujitjes dhe Kullimit**”, me FL në vlerën 1,349,812.5 lekë, OE i shpallur fitues ” E.” me vlerë të ofertës 1,114,770 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anulim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **1,114,770lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

C/L.5.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt **“Rikonstruksion i rrugës “Kënetë e Mitros”, Zharrëz, Patos**”, me FL në vlerën 14,166,604 lekë, OE i shpallur fitues ” S.” me vlerë të ofertës 12,424,120 lekë. *Nisur nga fakti se mosplotësimi i këtij kriteri nuk do sillte mosrealizimin e kontratës si dhe për përzgjedhjen e fituesit do të jetë çmimi më i ulët, ky BOE duhej të kualifikohej dhe shpallej fitues duke qenë se paraqiste ofertë më të mirë se sa operatori i kualifikuar dhe shpallur fitues. Vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet i shkaktuar nga refuzimi i ofertës së BOE “K. & S.” vlera prej **1,486,320 lekë** si diferencë e ofertës me të leverdishme me atë të shpallur fituese. Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **1,486,320lekë pa tvsh**, (diferencë ndërmjet vlerës së shpallur fituese dhe asaj të skualifikuar pa të drejtë), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.(*trajtuar më hollësisht në faqet 91-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).*

C/L.1-5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Patos, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për gjetjet e më sipërme, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën totale **46,521,420 lekë pa tvsh** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Brenda datës 30.09.2019

C/L.6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës prokurimit me objekt **“Rikonstruksion i rrugës Koli Marku”**, me FL në vlerën 59,992,633 lekë, OE i shpallur fitues “E.” me vlerë të ofertës 58,158,977 lekë. Është konstatuar se fondi limit është rritur në vlerën **215,760 lekë** pa TVSH, duke preventivuar më tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, neni 3, me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Patos.(*trajtuar më hollësisht në faqet 88-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/L.6.1. Rekomandim:**Bashkia Patos** të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla duke zbatuar në mënyrë rigorozë manualin teknik të çmimeve të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, për hartimin e preventivave të fondeve limit për procedurat e mëtejshme.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; geramat (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e

vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

E. MASA ADMINISTRATIVE:

E/I. Propozim APP-së për përjashtim nga procedurat e prokurimit publik për 1 OE

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik**, që **të vlerësojë shkeljen e konstatuar**, fillimin e procedimit administrativ, duke vendosur për përjashtimin e operatorit ekonomik “**S.**” **shpk**, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për procedurën me objekt: “Blerje mjet makine vetëshkarkuese” me vlerë të fondit limit 2,916,666 lekë dhe shpallur fitues OE “S.” me ofertë në vlerën 2,866,660 lekë, me arsyetimin **për sa më poshtë**:

Si rezultat i mosparaqitjes së mjetit sipas kushteve teknike të vendosura nga Njësia e Hartimit të dokumenteve të tenderit ,nga ana e AK nuk është marrë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LPP për OE i cili duhet të njoftonte brenda 3 muajve nga konstatimi në APP për përjashtim nga procedurat e prokurimit shoqërinë “S.” bazuar:

a. Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar” konkretisht: - nenit 13- Agjencia e Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për*

- pika 3ç – ***mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike***, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit

b. Në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës konkretisht:

-Pika 2. Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 tëLPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë (*trajtuar më hollësisht në faqet 86-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

E/II. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Patos t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (nëse ka IMTV,

ne te kundërt IKMT), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës, si më poshtë:

1. Gjobë në masën 50,000 lekë për Z. V. T., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me kontratën nr. 1535/11, datë 28.10.2016, për shkeljet e konstatuara në objektin “*Rikualifikimi Urban i Shëtitores Republika*”, Bashkia Patos, me sipërmarrës punimesh BOE “E.” shpk & “F.” SHPK & “A.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **161,000 lekë pa tvsh** dhe me kontratën nr. 2164/11, datë 27.02.2018, për shkeljet e konstatuara në objektin “*Ndërtimi i shërbimit me një ndalesë ONE STOP SHOP + Salla e Këshillit*”, Bashkia Patos, me sipërmarrës punimesh BOE “I. G.” SHPK & “H.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **505,250 lekë pa tvsh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

F. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA E TOKAVE BUJQËSORE, TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTUR (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Sektorit Taksave Bashkia Patos dhe 2 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimor për taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë për vlerën **37,059,828 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos (*Trajtuar në faqen 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), nuk janë zbatuar të gjitha etapat sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar. Neni 91- Pika 1 ku thuhet: “.. nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij”.

-Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, Pika 1 të ligjit të sipërcituar ku thuhet : “ *Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit*”.

-Nuk kanë zbatuar kërkesat sipas VKM. Nr.860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ *Për Sistemin e Taksave vendore*”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen ku rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **394 persona** me vlerë **13,309,757 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos. (*Trajtuar në faqet 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Bazuar në nenin 91-93 pika 1 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* ”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Patos të merren masa për të zbatuar të gjitha etapat për arkëtimin e detyrimeve për vlerën **37,059,828 lekë**, si më poshtë:

-Të arkëtohet vlera prej **13,309,757 lekë** sipas VKM. Nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “ *Për*

Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Të ndiqen **rrugët e mëposhtme**:

a-**Të ndiqen të gjitha etapat sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008** ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 91-93 (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike).

b- Bashkia Patos, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën prej **13,309,757 lekë**.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R